



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	18 .07.2018
Referenc-ë:	Ankesa nr.14-370/01-0171-433/18
Për/ Za/ To:	OE-ik "Marimanga"
CC:	
Përmes/Preko/Through:	
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj ,Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pergjegje ne ankesë



I nderuar,
Ankesa juaj është drejtuar gabimisht në Departamentin e Prokurimit,pasiqë pretendimet e paraqitura nuk kanë të bëjnë me këtë shërbim.
Zyra pritëse është e autorizuar për pranimin e të gjitha kërkesave,që d.t.th.edhe për pranimin e tenderëve që dorëzohen në formë fizike.Evidentimi i tenderëve të pranuar bëhet në formularin zyrtar:Regjistri i tenderëve të dorëzuar,në të cilin shënohen emri i tenderuesit,data dhe ora e dorëzimit të tenderit,numri fiskal dhe nënshkrimi i dorëzuesit të tenderit.
Lidhur me tenderin që ju keni pretendime ju sqarojmë se në regjistrin e tenderëve të dorëzuar janë regjistruar katër tender dhe të gjithë në afatin e paraparë-deri në orën 14:00.
Pretendimet tuaja janë të pa bazuara edhe për faktin se ju personalisht keni marrë pjesë në hapjen publike dhe nuk keni reaguuar lidhur me pretendimet tuaja,edhe pse në hapje publike janë lexuar çmimet e katër tenderueseve dhe poashtu në raportin e hapjes nuk keni shënuar asnjë vërejtje.Pse pretendimet tuaja i paraqitet pas hapjes është çështja e juaja dhe mund t'i drejtoni në Institucione tjera.

Bazuar në arsyet e paraqitura më lartë këtë ju njoftoj se ankesa juaj sa i përket procedurës së prokurimit,respektivisht dorëzimit dhe hapjes së tenderëve është e pa bazuar.

Shtojcë:
Regjistri i tenderëve të dorëzuar dhe
Procesverbali i hapjes së tenderëve